



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:195611

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05821820

**P.nr.2491/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Bujar Ahmeti dhe bashkëpunëtorin profesional Bekim Telaku, në çështjen penale kundër të pandehurve F.Rr. nga Komuna e Obiliqit dhe A.R. nga, Komuna e Lipjanit, për shkak të veprës penale vjedhje në bashkëkryerje dhe në tentativë nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2147/21 të datës 31.08.2021, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar publik me datë 11.06.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Besart Mustafa, të dëmtuarit K.A., të pandehurit F.Rr. dhe A.R. me mbrojtësin e tij av. Lridon Kutllovci sipas autorizimit, me datë 12.06.2024 publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 13.06.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

***Të pandehurit,***

- F.Rr.**, nga babai Rr. dhe nëna H., mbiemri i vajzërisë se nënës C., i lindur më datë ..., në .., Komuna e Obiliqit, rruga "...", nr., i martuar, baba i tre fëmijëve, punon, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, me numër personal ...
- A.R.**, nga babai I. dhe nëna M., mbiemri i vajzërisë se nënës R., i lindur më datë ..., Komuna e Lipjanit, i martuar, baba i dy fëmijëve, i pa punë, rast social, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, me numër personal ...

**JANË FAJTORË**

***Sepse:***

Me datë 02.05.2021, rreth orës 16:20, në rrugën "Shaqir Igrishta" në Prishtinë, të pandehurit F.Rr. dhe A.R. në bashkëkryerje, me qëllim që me përvetësimin e pasurisë së huaj të luajtshme, vetit t'i sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshëm, kanë shkuar në lokacionin e lartcekur me veturën e tyre pikap ngjyrë e bardh me targa ..., ashtu që kanë hyrë brenda në shtëpinë e tani të dëmtuarit K.A., e cila shtëpi kishte qenë e pa banuar, në atë mënyrë që nga aty kanë nxjerr një tavolinë buke së bashku me pesë kërriga dhe duke i ngarkuar në veturën e tyre, të njëjtit janë zënë në flagrancë nga i dëmtuari pronari i shtëpisë K.A., ku më pas të pandehurit janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes.

- Me këto veprime në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale *vjedhje në tentativë, nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 të KPRK-së.*

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39 par.1 pika 1.1 dhe 1.2, 40 par.1 pika 1.3, 43, 46, 47, 48, 69, 70, nenit 313 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 të KPRK-së, nenit 242, 364 dhe 449 të KPP-së, të pandehurit i:

## G J Y K O N

### I. Të pandehurit **F.Rr.** i shqipton:

- **DËNIM ME KUSHT**, ashtu që i cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri brenda kësaj periudhe nuk kryen vepër të re penale; dhe
- **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej treqind euro (300 €), të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej nga 30 (tridhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje të paguaj dënimin me gjobë në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ku një ditë burgim do t'i llogaritet me 20 € (njëzet euro) të gjobës.

### II. Të pandehurit **A.R.** i shqipton:

- **DËNIM ME KUSHT**, ashtu që i cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri brenda kësaj periudhe nuk kryen vepër të re penale; dhe
- **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej treqind euro (300 €), të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej nga 30 (tridhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje të paguaj dënimin me gjobë në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ku një ditë burgim do t'i llogaritet me 20 € (njëzet euro) të gjobës.
- I dëmtuari K.A., nga Prishtina, rruga "...", Kompleksi N.N.P "G.", për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.
- Obligohen të pandehurit që secili veç e veç të paguajnë shpenzimet procedurale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga njëzet (20) Euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej nga njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

### *Rrjedha e procedurës penale*

Prokuroria Themelore në Prishtinë, pranë kësaj gjykate, me datë 02.09.2021 ka dorëzuar aktakuzën me numër PP/II.nr.2147/21 të datës 31.08.2021 kundër të pandehurve F.Rr. dhe A.R., për shkak të veprës penale vjedhje në bashkëkryerje dhe në tentativë, nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 të KPRK-së.

Gjykata pas vlerësimit të kompetencës lëndore dhe territoriale dhe duke vepruar sipas aktakuzës, me datë 11.06.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilin seancë prezent ishin Prokurori i Shtetit Besart Mustafa, i dëmtuari K.A., të pandehurit F.Rr. dhe A.R. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. Liridon Kutllovci.

Gjyqtari i vetëm gjykuese në seancën e shqyrtimit fillestar i ka udhëzuar të pandehurit për të drejtat konform nenit 241 par.1 të KPP-së. Pas kësaj, Prokurori i Shtetit e ka lexuar aktakuzën dhe pasi gjyqtari u bind se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, bazuar në dispozitën e nenit 241 par. 4 të KPP-së të njëjtëve iu ofroi mundësinë që të pranojnë fajësinë ose të deklarohen të pafajshëm.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të pandehurit deklaruan se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilën i ngarkon aktakuza, se janë të vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat e këtij pranimi, duke shtuar se janë penduar, kërkojnë falje palës së dëmtuar dhe gjykatës dhe premtojnë se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla penale.

Pasi që të pandehurit në seancën e shqyrtimit fillestar e kanë pranuar fajësinë, konform nenin 242 par.5 të KPP-së gjyqtari ka marrë mendimin e palëve prezentë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Mbrojtësi i të pandehurit A.R. av. Liridon Kutllovci, ka deklaruar se e mbështesë pranimin e fajësisë, pasi që i njëjti është në përputhje me nenin 242 të KPPRK-së, i vullnetshëm me provat në shkresat e lëndës, si dhe në konsultim të mjaftueshëm me mua si mbrojtës dhe ka propozuar që pranimi i fajësisë të aprovohet nga gjykata. Ndërsa me rastin e matjes së shqiptimit të dënimit, përkatësisht llojit dhe lartësisë së tij, gjykata të ketë përsysh rrethanat posaçërisht lehtësuese për të pandehurin dhe atë pranimin e fajit, pendimin e thellë dhe kërkim falje ndaj organeve të rendit si dhe me premtim publik që vepra penale më kurrë nuk do të përsëritet, të gjitha këto të ndërmarra nga një gjendje e çastit, gjykata besoj duhet ta ketë parasysh faktin se i pandehuri tashmë është penduar për këto veprime. Tutje ka shtuar se tashmë i pandehuri Alban ka filluar një jetë të re jashtë vendit dhe i cili kujdeset për dy fëmijët e tij, dhe e lut gjykatën që të njëjtit t'i shqiptoj një dënim sa më të butë, i cili dënim do të ishte në përputhje me nenin 38 të KPRK-së.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurit, pasi që ky pranim është në pajtim të plotë me nenin 242 të KPP-së dhe po ashtu është në harmoni të plotë edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, me të cilat është vërtetuar se të pandehurit e kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që ta miratoj pranimin e fajësisë. Ndërsa me rastin e shqiptimit të dënimit, gjykatës i ka propozuar që si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë se të pandehurve, kurse si rrethanë rënduese të merret parasysh intensiteti i dashjes në kryerjen e veprës penale.

I dëmtuar K.A. ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë, sa i përket ndjekjes penale i lë në vlerësim gjykatës dhe ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

*Vlerësimi i gjykatës lidhur me pranimin e fajësisë.*

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e kanë deklaruar të pandehurit dhe erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve është bërë në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPP-së dhe në pajtim edhe me faktet dhe provat që përmban aktakuza, njëherit vlerësoi se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe mbështet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike dhe po ashtu gjykata sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 251 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme. Pasi gjyqtari i vetëm gjykuese u bind se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën, benefitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe pasi që konstatoi se pranimi është në përputhje me nenin 242 par. 2 të KPP-së, me aktvendim e aprovoi pranimin e fajësisë së të pandehurve, për veprën penale vjedhje në bashkëkryerje dhe në tetantivë, nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 të KPRK-së.

Me qenë se të pandehurit e kanë pranuar fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë, e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave në këtë çështje penale, por shqyrtimi fillestar ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

*Gjendja faktike e vërtetuar.*

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurve dhe nga provat të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të pandehurve formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 28 të KPRK-së, të përshkruar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e për të cilën veprë penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, dhe për këtë gjykata ka vendosur që të pandehurit t'i shpall fajtor dhe t'iu shqiptoj dënimin me burgim e të kushtëzuar dhe dënimin me gjobë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penale juridike.

*Rrethanat me rastin e matjes dhe lartësisë së dënimit.*

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë lehtësuese vlerësoi faktin e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurve për veprën penale për të cilën akuzohen, keqardhjen e shfaqur nga të njëjtit për rastin e ndodhur, kërkim faljen palës së dëmtuar dhe pendimin për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata përveç shkallës së përgjegjësisë penale të pandehurve, rrethanë tjetër rënduese nuk ka gjetur.

Pasi që për këtë veprë penale parashihet dënim kumulativ me gjobë dhe me burgim, gjykata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të elaboruara si më lartë, të njëjtëve iu shqiptoj dënimin me burgim e të kushtëzuar dhe dënimin me gjobë sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimit, duke pasur paraysh edhe faktin se vepra penale ka mbetur në tentativë, e në dispozitivin e nenit 28

par. 3 të KPRK-së është paraparë që “personi që tenton të kryejë veprë penale dënohet si të kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet”. Gjykata përkitazi me dënimin me kusht mori për bazë keqardhjen e shfaqur për rastin që ka ndodhur, pendimin e shprehur, kërkim faljen palës së dëmtuar dhe faktin se vepra penale ka mbetur tentativë. Gjykata në prani të këtyre rrethanave konsideron se të pandehurit e kanë kuptuar rëndësinë e veprimeve të dëmshme dhe në këtë mënyrë iu dha edhe një mundësi të pandehurve të kushtëzohen në ekzekutim të dënimit me burgim, duke i lënë një periudhë të verifikimit prej një viti pasi që gjykata paraprakisht u bind se të njëjtit nuk do të përsërisin veprimet e tyre, dhe mbi bazën e këtyre rrethanave, gjyqtari njëherit është i bindur se dënimi i shqiptuar me kusht dhe me gjobë është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurve, kështu gjykata vlerëson se me shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e veprës penale dhe të kryesve, po ashtu ky dënim do të shërbejë në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale), si dhe do të arrihet qëllimi që t’i përmbaj edhe personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

#### *Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike*

Lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 462 par. 1 dhe 2 të KPP-së, ku të dëmtuarin, për realizmin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontestin civil.

#### *Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale*

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës penale, në kuptim të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPP-së, obligoi të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën prej nga 20 (njëzet) €. Po ashtu, konform nenit 36 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit Nr.08/L -109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të pandehurit që secili veç e veç të paguajnë shumën prej nga 20 € (njëzet euro) në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.2491/21 datë 13.06.2024

**Bashkëpunëtor profesional**

Bekim Telaku

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**

Bujar Ahmeti

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditëve prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.